



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 29

Datë: 30. 11. 2023. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Mybera Shinik ,Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

R ENDI I DITËS

- 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**
- 2. Caktimi i anëtares se re të KQZ-së, në Keshillat e KQZ-së**
- 3. Raportet e Këshillave të KQZ-së:**

3.1.Këshilli për Operacione Zgjedhore

1. -Shqyrtimi dhe miratimi i kompozimit të melodisë së KQZ-së
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit “Analizimi i të dhënave të zgjedhjeve të kaluara për përfaqësimin gjinor në TMZ”.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Projektit “Pjesëmarrja e barabartë gjinore më TMZ,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit “ Zbatimi i Periudhës së Shërbimit të Votuesve për Ndërrimin e Qendrave të Votimit”,

5. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-agjendës dhe përbërjes në “Punëtorinë në mes zyrtarëve komunal të zgjedhjeve e përkrahur dhe financuar nga OSBE,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të vizitave në teren,
7. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për Projektin “Informimi dhe Edukimi i Votuesëve të Rinjë për Zgjedhjet”

4. Të ndryshme

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Krvesues i mbledhjes së KOZ-së:

Kryetari **Kreshnik Radoniqi**, e hapi mbledhjen dhe i uroi mirëseardhje anëtarës së re Mybera Shnik, e cila e zëvëndëson ish anëtarin Rifat Krasniq. Ai tha se, “do të punojmë së bashku dhe ju dëshiroj mirëseardhje”. Në lidhje me agjendë, Radoniqi tha se është një kërkesë nga komiteti i auditimit, janë dy pika për shqyrtim: plotësim – ndryshimin e statusit neni 10, dhe ndryshimin e planit të punës së njësisë së auditimit për vitin 2023.

Arianit Elshani, duke i dëshiruar mirëseardhjes anëtarës së re, tha se te pika 4 e agjendës së mbledhjes, pavarësisht miratimit në KOZ është kërkuar që të sqarohet më mirë lidhur me statistikat, prandaj të hiqet nga rendi i ditës...

Alban Krasniqi, kërkoi që në rend të ditës një pikë nga Këshilli për Personel.

Me 11 vota për, u miratua rendi i ditës.

2. Caktimi i anëtares se re të KOZ-së, në Keshillat e KOZ-së :

Kreshnik Radoniqi, tha se anëtari Rifat Krasniq ishte vetëm në këshillin për Marrdhënie me Jashtë dhe se anëtarja e re i bie me qenë vetëm në një këshill.

Alban Krasniqi, tha se është mirë që znj. Mybera të jetë në Këshillin për Cështje Ligjore, ngase këtu ishte z. Selmanaj...!

Kreshnik Radoniqi: Në këtë këshill, jam unë...

Alban Krasniqi: Mendoj që përfaqësimi i anëtarëve në këshilla do ishte sa më i barabartë, për aq sa është e mundur...

Kreshnik Radoniqi: Atëherë, znj, Mybera të jetë tash për tash në këshillin për marrëdhënie me jashtë, si zëvdnëskryesuese e këshillit.

Me 11 vota për, u miratua...

3. Raportet e Këshillave të KQZ-së

3.1.Këshilli për Operacione Zgjedhore:

Shqyrtimi dhe miratimi i kompozimit të melodisë së KQZ-së

Arianit Elshani, kryesues i KOZ-it e elaboroi rrjedhën e konkursit dhe, fituesin në vendin e parë: e që është komponomi i kompozitorit Valton Beqiri, e pastaj sipas komisionit vlerësues të ekspertëve – profesional, kjo tani është melodia e KQZ-së.

Pas një debati, kryesisht rreth konceptit dhe implementimit, përzgjedhjes etj., anëtarët e KQZ-së miratuan raportin vlerësues lidhur me përzgjedhjen e melodisë së KQZ –së nga komisioni i konkursit: me 10 vota për, dhe 1 abstenim (Alban Krasniqi). Ndërkaq, anëtarët e KQZ-së me 8 vota për, miratuan po ashtu, melodinë e parë: atë të kompozitorit Beqiri. Ndërsa, për melodinë e dytë, votuan 2 anëtarë, dhe 1 abstenoi...

Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit “Analizimi i të dhënave të zgjedhjeve të kaluara për përfaqësimin gjinor në TMZ”:

Arianit Elshani, raportoi lidhur me këtë pikë mbi të dhënat e zgjedhjeve të kaluara, mbi përfaqësimin gjinorë. Të dhënat e KKZ-ve, janë pasqyruar në në rapor. Ai tha se, 15 % e grave, përfaqësohen në KKZ –të komunale, dhe 85% (zgjedhjet e vitit 2021). Në raport, janë bërë analizat e gjinisë së përfaqësuar, qoftë për zgjedhjet qendrore, qoftë për zgjedhjet lokale. Nga ky raport, z. Elshani tha se, ka diskrepanca të theksuar në përfaqësimin gjinorë. Sekrteariati, ka bërë 4 rekomandime për tu marrë parasysh lidhur me trupat menaxhues zgjedhorë.

Kjo analizë, do të shqyrtohet në një takim më 9 nëntorë, e pastaj edhe nëpër komuna. Në fund, z. Elshani kërkoi që analiza të miratohet.

Sami Kurteshi, tha se rekomandimet janë në përputhje me ligjin. Ai shtoi se, mangësitë janë të mëdha, mirëpo ai kërkoi që do duhej edhe partitë politike mund të ndihmojnë në këtë drejtim – në përfaqësim. Në përgjithësi, është pjesëmarrje tejet e vogël. Se di sa do të ndikojmë ne...

Në diskutim, u përfshi edhe z. Sami Hamiti i cili konstatoi se raporti paraqet gjendjen reale, por ai tha se duhet edhe faktorët e tjerë duhet të kyqen dhe kjo gjendje të përmirësohet... Pastaj, diskutoi edhe Alban Krasniqi, i cili tha se raporti duhet dhe mund të plotësohet, mirëpo ai shprehu nevojën që të zgjerohet rrethi i personave, institucioneve me të cilat mund të presim që përfaqësimi gjinorë të jetë shumë më sasior, e cilësorë...

Diskutoi pastaj, edhe Ibrahim Selmanaj, Ilir Gashi, Čemailj Kurtiš dhe Arianit Elshani.

Analiza, u miratua me 11 vota.

Shqyrtimi dhe miratimi i Projektit “Pjesëmarrja e barabartë gjinore më TMZ:

Arianit Elshani, tha se KOZ ka shqyrtuar edhe projektin “Pjesëmarrja e barabartë gjinore më TMZ”. Ky projekt, është paraparë të shqyrtohet e debatohet me 9 nëntor, dhe është projekt i paraparë me plan të punës. Mbështetet nga OSBE, dhe do të organizohet edhe në 7 komuna, por edhe në ndëonjë komunë tjetër që nuk ka qenë e paraparë... Është edhe lista e pjesëmarrësve, pra do të ftohen ata që e kanë vendin në këtë takim...

E rekomandojmë projektin dhe agjendën, ndërsa për listën në vazhdim mund të plotësohet më tutje...

Kreshnik Radoniqi: Unë me këtë datë nuk jamë, mirëpo duhet të më zëvendësoj dikush. Projekti, në fund u miratua me 11 vota...

Shqyrtimi dhe miratimi i draft-agjendës dhe përbërjes në “Punëtorinë në mes zyrtarëve komunal të zgjedhjeve e përkrahur dhe financiar nga OSBE:

Arianit Elshani, iu referua agjendës së KOZ-it ku tha se, është shqyrtuar edhe draft – agjenda e një punëtorie në mes të zyrtarëve komunal të zgjedhjeve që do të përkrahet nga financiarisht nga OSBE.

Ai, e shpjegoi thelbin e agjendës. Pra, veq rregulloreve, do të duhet të kemi edhe vizita në terren, prandaj ju njoftoj se më 1 dhe 2 nëntor mbahet takimi. Takimi, mbahet në Pejë.

Vendi i takimit, u kontestua nga **Alban Krasniqi**, i cili diskutoi gjatë. Ai, tha se thelbi – përmbajtja e mbajtjes së kësaj punëtorie janë të përgatitura keq, nuk e përmbushin qëllimin. Unë e kam shkruar një imell, sepse nuk kuptohet mënyra që me i bë gjërat shkel e shko...

Diskutoi, edhe: **Sami Kurteshi**, i cili tha se nuk e kemi planin e punës, nuk e kemi një strategji të planit të punës...Nuk po e kuptoj së paku rolin tim në këtë punëtori ! Pastaj, diskutoi edhe **Sami Hamiti** i cili, kërkoi që të shpjegohet nga sekretariati shpjegimi, dhe gjërta të mos mbeten mjegull...

Arianit Elshani, shpjegoi çështjet e organizimit, identifikimin e planit të punës, arsyet pse organizohen këto takime etj.

Në fund, draft – agjenda u miratua me 8 vota. Kundër ishin 2, dhe 1 abstenim.

Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të vizitave në teren:

Arianit Elshani, tha se, një raport apo plan ka qenë edhe në vitin e kaluar, por e kemi shtyrë për këtë vit. Ai, rikujtoi çështjet, qëllimin, objektivat e vizitave në terren, takimet me kryetarët e komunave...

Në këtë pikë, diskutuan: **Ilir Gashi**, i cili tha se, sekretariati apo zlkz-të kanë të dhëna dhe nevoja, dhe secili ekip duhet ti ketë “agjendat” se, për cka ne duhet të takohemi me kryetarët e komunave...Pra, sipas “raporteve” që duhet ti kemi secili ekip, di se ku dhe pse duhet të shkojë në ndonjë komunë...

Diskutuan edhe: Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Fazli Stollaj, Kreshnik Radoniqi etj.

Kjo pikë, u shty që të plotësohet më shumë, dhe të sillet në mbledhjen e ardhshme.

4.Komiteti i Auditimit

Sami Kurteshi, tha se si komitet po ju raportoj për dy pika. I kam dërguar edhe dokumentet. Në takimin e fundit me 9 tetor, kemi miratuar këto dokumente. Pra, ne duhet të shohim e shqyrtojmë paragrafit 10, në lidhje me kompensimin material të anëtarëve të komitetit. Këtë, duhet ta bëj KQZ. Këtkoj që të miratohet ndryshimi i nenit 10, paragrafi 1 i statutit...

Në këtë çështje diskutuan: **Alban Krasniqi**, i cili tha se, kjo të shihet në relacion me komitet e tjera, por edhe dokumentet ti shohim më detajisht...Mendoj që, kur të marrim vendim, të sigurohemi mirë, pra na jepni kohë...

Arianit Elshani, tha se statutin e kemi miratuar dhe formimin e komitetit në vitin 2021. Jam për miratimin e këtij ndryshimi, por që ta kemi orientimin e qartë...

Sami Kurteshi: Mirë, e shqyrtojmë edhe në mbledhjen e ardhshme...Ndërsa, çështja e dytë, është një kërkesë e auditorit të brendshëm për ndryshimin e auditimit: anulim i një aktiviteti, në mënyrë që ky aktivitet të bartet në fillim të vitit të ardhshëm 2024. Fjala është për auditimin e Këshillit të Personelit. Në komitet, tekstin e miratar.

Arianit Elshani tha se në parim, jamë për shtyrje. Mirëpo, ka të meta raporti në çështjen e auditimit – të përkufizohet, ku, cka, si...?

Diskutuan: Ibrahim Selmanaj, Alban Krasniqi, Ilir Gashi, Sami Kurteshi, i cili tha se auditori ka kërkuar shtyrje, dhe se auditori mund ta specifikoj kërkesën... Pastaj, diskutoi edhe Sami Hamiti, Arianit Elshani dhe Kreshnik Radoniqi.

Sami Kurteshi: Ne, e kemi shqyrtuar dhe miratuar raportin e auditimit lidhur me procesin e prokurimit në KQZ. Ju njoftoj, prandaj edhe do e përcjelli te të gjithë ju. Ishte edhe një raport për procesin e rekrutimit për ZLKZ-të. Ne, e kemi votuar edhe

pse, nuk kemi pasur të drejtë...E keni marrë raportin...Cështja e tretë: ne, nuk kemi arritur ta shohim raportin e zbatimit të rekomandimeve të Zyres Kombëtare...! Këtë raport, do ta diskutojmë në mbledhjen e radhë së komitetit...

5. Këshilli për Personel

Alban Krasniqi:...qe pse edhe ishte dashur me u ba audimi në këshill të personelit. E para që po du me vu në pah, është se puna e personelit zhvillohet pa asnjë standard, pa asnjë bazë ligjore, me tejkalime e anashkalime procedurale të panumërta, dhe me vendime që gjoja i nxjerrë komisioni për shqyrtimin e ankesave...veq, shiheni përbërjen e këtij komisioni që s'jan fare kompetent: një përkthyes, dy anëtarë nga kryesuesit e KKZ-ve.

E dyta, ka mungesë totale të transparencës...! Fshihen të dhënat, dokumentet...! E njëjta gjë, është edhe me Arkivën. Edhe kur kërkon, nuk do të dërgohen dokumentet nga arkiva. Tjetra: është shqetësues edhe vet zgjedhja e kryeshefit ! Ky, dërgon ankesë një “komisioni të ankesave” që vet e ka formu. Ky komision, vepron në suaza ët një udhëzimi që, vet kryeshefi pararendës e ka nënshkrue...

Pastaj, raporti rreth zgjedhje së kryeshefit...madje, as raporti nuk na dërgohet, pra ka shkelje, manipulime... vlerësim të tij nuk kemi ba, por tani është një dokument që është dërgue te KPMSHC-ja, por mbi cfarë baze është bë vlerësimi, në mbledhje ne vlerësim nuk kemi ba...Ku është bë, nëse ëshë bë...?

Kjo, është shkelje e rënd, prandaj kjo çështje duhet të marrë një kahje! Në vazhdim, z. Krasniqi, e elabori çështjen e “kryeshefit” në aspekte më të gjera, duke e trajtuar dhe elaboruar si shkelje, fshehje të procedurave, të letrave etj. Në vazhdim, z. Krasniqi raportoi edhe mbi konkurset lidhur me kryesuesit e KKZ-ve, implementimin e tyre si në Lipjan, të cilin rast e trajtoi si tejet eklatant...

Kreshnik Radoniqi: Kanë ardhur vendimet nga KRSHPC, dhe nëse nuk do zbatohet vendimi, kjo përbën vepër penale. Nuk e kemi këtë mundësi...!

(Në vazhdim, u zhvillua një polemikë në mes të z. Alban Krasniqi dhe të kryetarit Radoniqi)

Në diskutim të kësaj pike folën edhe Arianit Elshani, Sami Kurteshi i cili tha se nuk ka rekrutim deri më sot, sa jam unë, që nuk përcillet me këso probleme. Edhe, gjithnjë problemet përcillen nga zyra e personelit, atje dalin sepse, kjo përcillet edhe me qëndrimin e kryeshefit... Mbi 80% të rekrutimeve tona, përcillen me këso probleme.

Kreshnik Radoniqi: Këto duhet ti rregullojmë me rregullore për cdo rekrutim, procedurat etj. Rregullat zgjedhore, rregulloren e brendshme ne duhet ti përfundojmë sepse, e kemi obligim ligjor...

Diskutoi edhe, Arianit Elshani, Sami Kurteshi,